



Raport & Procesverbal nga konsultimi publik për Draft RREGULLORE PËR BONUSSET E ZONIMIT

Komuna e Podujevës ka mbajtur debatin Publik për propozim rregulloren për Bonuset e Zonimit të organizuar nga drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes e Mjedisit më datën 12 tetor 2022 duke filluar nga ora 17:00 në ndërtesën e Komunës së Podujevës, Kati përdhësë – Salla e mbledhjeve, e sipas vendimit të kuvendit numër 01-350/04-0084093/22, datë 29.09.2022.

Numri i pjesëmarrësve në takim gjithsejt 13.

Takimi e kryesoj drejtori i DPUMM z.Leutrim Krasniqi i cili e prezantoi draftin rregullore duke elaboruar dispozitat e përgjithshme të rregullores, ndarjen e bonuseve, aplikimin dhe marrëveshjen për rregullore, procedura e ankesave etj.

Gjatë debatit të pranishmit diskutuan rreth bonuseve të zonimit, për zvogëlimin e kushtit për sipërfaqen minimale të parcelës, rritjes së përqindjes së sipërfaqes së shfrytëzueshmërisë së, shputës në raport me parcelën kadastrale, rritjen e lartësisë dhe kateve maksimale të ndërtesës si dhe çështje tjera për të cilat pjesëmarrësit kishin interesim. Ndër të tjera disa nga të pranishmit shtruan pyetjet si më poshtë:

Arkitekt – Korab Syla

1. Në marrëveshjen për bonuset e zonimit a hyn edhe pronarët e tokave apo vetëm investitorët?
2. Në sipërfaqet ndërtimore që fitohen nga bonuset e zonimit a do të ketë lehtësime në pagesat e taksës administrative?
3. Nëse të gjithë investitorët zgjedhin njërin bonus që i'u konvenon më shumë, vendos DPUMM nëse është i nevojshëm apo jo brenda bllokut të caktuar.(Duhet të theksohet në rregulloren për bonuset e zonimit).

Qytetari - Rrahman Islami

1. Kritikat për vazhdimin dhe vonesat në ndërtim – Adriatiku Sh.p.k.

Qytetari – Arben Kastrati

1. Sqarime shtesë për kalkulimet në etazhitet për objektet ekzistuese.
2. A mund të shndërrohen bonuset e zonimit në mjete financiare apo vetëm hapësira ndërtimore?

Arkitekt – Korab Syla

1. A ka mundësi të zgjedhet ndonjëri nga bonuset e zonimit

Qytetar – Liridon Llapashtica

1. Mendoj se nuk janë të barabarta 10% e sipërfaqes bruto të ndërtimit të bonusit me 5% Sipërfaqe së përgjithshme të parcelës sepse 1 ari tokë në Podujevë nuk kushon 300 000 euro.

Drejtori krasniqi dha sqarimet e nevojshme nga pyetjet e shtruara, i ftoi pjesëmarrësit e këtij debati dhe qytetarët e komunës së Podujevës që të gjitha propozimet, sygjerimet apo kritikrat t'i adresojnë edhe përmes e-mail adresës të caktuar, apo edhe në formë fizike deri me 5 nëntor.

Kërkesat për bonuset e zonimit

- Enver Shabani – Adriatiku – (23.11.2022)
Kërkesë nga kompani “Adriatiku SH.P.K.” që Bonuset e zonimit për ndërtime të larta nga 10%, bruto të zvogëlohet në 2%.
- Enver Shabani – Adriatiku – (23.11.2022)
Kërkesë për projektet që janë paisur me leje ndërtimore dhe janë në punime e sipër të përfshihen në Hartë Zonale.

Kërkresa përmes e-mail – (02.11.2022)

- Kompania “Flori” kërkesë nga 10% për bonuset e ndërtimit të zbrësë në 2% me qenë se ne kalkulim hyjnë edhe 12% i ndërtimit komunikim vertikal dhe horizontal.

Kontributi i secilit pjesëmarrës dhe qytetar që kanë parashtruar pyetje e kërkesa kanë bërë që rregullorja për Bonuset e Zonimit në Komunën e Podujevës të jetë sa më e kompletuar.

Punoi
Flaka Ademi











Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat Publik për propozim Rregulloren për Bonuset e Zonimit

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrëseve

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Nasrrije Haliti	Podujeve	
2	FLAKA ADEMI	PODUJEVË	
3	Krahman Isaković	Podujeve	
4	ARBEN KASTRATI	PODUJEVË	
5	Enver Shaloni	PODUJEVË	
6	FLORIE MANI	PODUJEVË	
7	VETON ALIU	PODUJEVË	
8	VALDET MAZOKU	PODUJEVË	
9	OSMAN THAÇI	PODUJEVË	
10	KOVACS VADOL	KFOR	
11	HALIL KASTRATI	PODUJEVË	
12	LIRIJON LAPASHTICA	PRISTINE	
13	KORAB SYLA	PODUJEVË	
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			